



Kosovo Property Claims Commission
Komisioni i Kërkesave Pronësore të Kosovës
Komisija Kosovske Agencije za Imovinu

Nazim Gafurri 1 (Miladin Popovic)
Pristina
Tel: +381 (0) 38 249-918
Fax: +381 (0) 38 249-919
E-mail: mailbox@kpaonline.org

VENDIM

PANELI NR: 1

VENDIMI NR.KPCC/D/A/60/2010/CORR1
DATA E VENDIMIT: 25/02/2010
DATA E PERMISIMIT: 15/09/2010

URDHËR

(1) Në secilën prej 478 (katërqind e shtatëdhjetë e tetë) kërkesave të përmendura në pjesët A, B dhe C dhe të Listës së bashkëngjitur, Komisioni

vendos që:

Paraqitësi i kërkesës apo bartësi i së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, ka dëshmuar pronësinë mbi pronën e kërkuar, apo mbi pjesën e tillë siç është specifikuar në vendimin përkatës individual;

(2) Në secilën prej 389 (treqind e tetëdhjetë e nente) kërkesave të përmendura në pjesën D të Listës së bashkëngjitur, Komisioni

vendos që

Paraqitësi i kërkesës ka dëshmuar pronësinë e bartësit të ndjerë të së drejtës pronësore mbi pronën e kërkuar, apo mbi pjesën e tillë siç është specifikuar në vendimin përkatës individual;

(3) Në secilën prej 867 (tetëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) kërkesave të përmendura në paragrafët (1) dhe (2) të mësipërm, përveç Kërkesave nr 37857, 37834, 43146, 47121, 47122 dhe 47124, Komisioni

urdhëron që

(a) Paraqitësit të kërkesës apo bartësit të së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, t'i jepet posedimi i pronës së kërkuar;

- (b) *Pala përgjegjëse dhe çdo person tjetër i cili ka uzurpuar pronën, ta lirojë atë brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimit të këtij urdhri; dhe*
- (c) *Nëse pala përgjegjëse apo çdo person tjetër i cili ka uzurpuar pronën dështon të përmbush urdhrin për lirim të pronës brenda kohës së dhënë, ata do të dëbohen nga prona;*
- (4) *Në secilën kërkesë të përmendur në kolonat përkatëse në pjesët A, B, C dhe D të Listës së bashkëngjitur, Komisioni më tutje vendos që kërkesat të refuzohen për aq sa paraqitësi i kërkesës kërkon kompensim për dëmin material, apo humbjen e shfrytëzimit, të pronës së kërkuar; dhe*
- (5) *Në rastet kur ka më shumë se një pronar, vendimet dhe urdhri i mësipërm nuk ndikojnë në të drejtat e asnjërit nga bashkë-pronarët përkatës.*

KORNIZA LIGJORE

1. Më 13 qershor 2008, Kuvendi i Republikës së Kosovës ("Kuvendi") ka miratuar Ligjin Nr. 03/L-079 duke plotësuar dhe ndryshuar Rregulloren e UNMIK-ut 2006/50 ("UNMIK/REG/2006/50") mbi zgjidhjen e kërkesave që kanë të bëjnë me pronën e paluajtshme private, përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale. Ligji përmban një aneks ("Aneksi I") duke plotësuar dhe ndryshuar Urdhëresën Administrative të UNMIK-ut Nr. 2007/5 ("UNMIK/ADM/DIR/2007/5"), e cila zbaton UNMIK/REG/2006/50. Me Ligjin Nr. 03/L-079 dhe Aneksin I themelohet Agjencia Kosovare e Pronës ("KPA") si agjenci e pavarur sipas Nenit 142 të Kushtetutës së Kosovës, dhe ndryshohen dispozitat përkatëse të UNMIK/REG/2006/50 dhe UNMIK/ADM/DIR/2007/5 si të domosdoshme për të zbatuar ndryshimet në kornizën e aplikueshme ligjore. Në pajtueshmëri me dispozitat e tyre, Ligji Nr. 03/L-079 dhe Aneksi I kanë hyrë në fuqi me publikimin e tyre në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

2. Sipas nenit 22 të UNMIK/REG/2006/50, Rregullorja pushon së aplikuari me datën 31 dhjetor 2008. Prandaj, Ligji Nr. 03/L-079 është aktualisht burimi i vetëm i autoritetit ligjor të Komisionit. Dispozitat e UNMIK/REG/2006/50 vazhdojnë të mbesin relevante vetëm ashtu siç janë inkorporuar sipas Ligjit Nr. 03/L-079.

ARSYET PËR VENDIM

3. Paraqitësi i kërkesës apo bartësi i së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, ka të drejtë në urdhër nga Komisioni për riposedit të pronës, nëse paraqitësi i kërkesës dëshmon:

- (a) pronësinë mbi pronën e paluajtshme private, përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale; ose
- (b) të drejtën e shfrytëzimit në lidhje me pronën e paluajtshme private, përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale,

ku paraqitësi i kërkesës apo bartësi i së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, tani nuk mund të ushtrojë të drejta të tilla pronësore, dhe ku kërkesa përfshin rrethanat e ndërlidhura drejtpërsëdrejti me, apo që janë pasojë e konfliktit të armatosur që ka ndodhur në Kosovë mes 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999. (Shih nenin 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të miratuar me Ligjin Nr. 03/L-079.)

4. Kur paraqitësi i kërkesës paraqet kërkesë për pronësi në bazë të nenit 3.1(a) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të miratuar me Ligjin Nr. 03/L-079, Komisioni duhet ta zgjidhë çështjen e pronësisë dhe, nëse Komisionit i është dëshmuar pronësia dhe paraqitësi i kërkesës nuk e dëshmon të kundërtën, të jap urdhër për riposëdim në dobi të paraqitësit të kërkesës apo bartësit të së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti. Kur paraqitësi i kërkesës paraqet kërkesë për të drejtën e shfrytëzimit të pronës në pajtim me nenin 3.1(b) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 miratuar me Ligjin Nr. 03/L-079, Komisioni mund të shqyrtojë kërkesën me procedurë përmbledhëse dhe të lëshojë urdhër për kthimin e posedimit. (Shih nenin 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, lexo bashkë me nenin 9 të Aneksit III të Urdhërësës Administrative nr. 2007/5 miratuar me Ligjin Nr. 03/L-079.)¹

5. Komisioni ka mbajtur seancën e tij të pesëmbëdhjetë prej 22 deri 25 shkurt 2010 në Prishtinë. Gjithsejt 1,084 kërkesa për pronë bujqësore i janë paraqitur Komisionit në seancën e tij të pesëmbëdhjetë, nga Sekretaria Ekzekutive e KPA-së ("Sekretaria Ekzekutive"), së bashku me dokumentacionin mbështetës, raportet e përpunimit të kërkesave, raportet e verifikimit, memorandumet ligjore dhe informata tjera relevante. Më tej, dy kërkesa pronësore banesore që i janë paraqitur Komisionit janë ri-kategorizuar gjatë seancës nga Komisioni si kërkesa pronësore bujqësore. Komisioni gjithashtu ka finalizuar vendimin mbi 16 kërkesa shtesë të cilat i ishin paraqitur nga Sekretaria Ekzekutive në seancën e tij të 13-të, në të cilat Komisioni kishte ndërprerë shqyrtimet në pritje të konfirmimit të notifikimit fizik të kërkesave për pronat e kërkuara.

6. Në seancën e Komisionit, Sekretaria Ekzekutive i ka prezantuar kërkesat Komisionit dhe i ka raportuar mbi përpunimin e kërkesave, dhe çështjet ligjore dhe dëshmuese të cilat kanë rrjedhur nga kërkesat. Më kërkesë të Komisionit, Sekretaria Ekzekutive ka ofruar informata dhe sqarime shtesë, sipas nevojës.

¹ Duket se ka një gabim teknik në Aneksin I. Ndonëse në mënyrë të qartë paraqitet që Aneksi I kishte për qëllim të zëvendësonte në tërësi Urdhërësën Administrative të UNMIK-ut 2007/5, përfshirë që të tri Aneksat e saj, Neni 26 i Aneksit I parasheh që e drejta nga Aneksi III i Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 duhet të zëvendësohet me të drejtën e cila referohet në Aneksin II. Megjithatë, nuk ka ndonjë dispozitë të veçantë apo ndonjë të dhënë tjetër në Ligjin 03/L-079 apo në Aneksat e tij që qëllimi i këtij ndryshimi të veçantë ishte të heq Aneksin I apo Aneksin II të Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut. Rrjedhimisht, Komisioni konsideron që të tri Aneksat e Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 janë përfshirë në pakon legjislative dhe Komisioni do t'u referohet në këtë vendim si Nën-Aneksat I, II dhe III, respektivisht.

A. Kërkesat për pronësi

7. Në të gjitha kërkesat e përfshira në këtë vendim, paraqitësit e kërkesave kërkojnë zgjidhjen e kërkesës për pronësinë, dhe që të gjitha kanë të bëjnë me pronat bujqësore, përfshirë arat, kullotat dhe pyjet.

8. Ky vendim trajton 874 kërkesat pronësore bujqësore të regjistruara në pjesët A, B, C dhe D të Listës së bashkëngjitur. Bazuar në shqyrtimin e kërkesave dhe në dokumentacionin mbështetës gjatë seancës si dhe në informatat e ofruara dhe verifikimin e bërë nga Sekretaria Ekzekutive, gjithsejt 13 kërkesa për pronë bujqësore i janë kthyer Sekretarisë Ekzekutive nga Komisioni për verifikim dhe shqyrtim të mëtejshëm ose janë tërhequr nga Sekretaria Ekzekutive. Këto kërkesa, të cilat janë regjistruar në pjesën E (“Kërkesat e kthyer”) dhe pjesën F (“Kërkesat e tërhequra”) të Listës së bashkëngjitur këtij vendimi do të shqyrtohen nga Komisioni në kohën e duhur. 215 kërkesa tjera për pronë bujqësore përfshihen në dy vendime tjera, më saktësisht në KPCC/D/A/61/2010 dhe KPCC/D/A/62/2010.

9. Komisioni vëren se të gjitha kërkesat e regjistruara në pjesët A, B, C dhe D të listës së bashkëngjitur janë jokontestuese në kuptimin se në kohën e notifikimit të pronave të kërkuara nuk ka pasur dëshmi të uzurpimit, shfrytëzimit apo kultivimit të paligjshëm të këtyre pronave nga ndonjë person ose, edhe kur ka pasur dëshmi të tilla, asnjë palë nuk e ka kontestuar vlefshmërinë e kërkesës brenda periudhës prej 30 ditësh të paraparë në nenin 10.2 të UNMIK/REG/2006/50 miratuar me Ligjin nr. 03/L-079. Bazuar në informatat e ofruara nga Sekretaria Ekzekutive, Komisioni është i kënaqur që Sekretaria Ekzekutive ka bërë përpjekje të arsyeshme për të notifikuar pronat e kërkuara, personat të cilët aktualisht mund t’i kenë uzurpuar pronat, dhe persona tjerë të cilët mund të kenë interes ligjor në pronat e tilla, siç kërkohej nga neni 10.1 i UNMIK/REG/2006/50 dhe neni 10.1 i Ligjit Nr. 03/L-079. Rrjedhimisht, këto kërkesa duhet të konsiderohen si jokontestuese.

10. Në kërkesat e përmendura në pjesët A, B, C dhe D të listës së bashkëngjitur, Komisioni vëren se paraqitësit e kërkesave kanë paraqitur lloje të ndryshme të dokumenteve në mbështetje të kërkesave për pronësinë, përfshirë fletët poseduese, kontratat mbi shitblerjen, kontratat mbi dhurimin, kontratat mbi ndarjen e pasurisë, vendimet mbi trashëgiminë, vendimet e gjykatës mbi njohjen e pronësisë, kontratat mbi përkujdesjen jetësore dhe certifikatat për të drejtat mbi pronën e paluajtshme. Komisioni është i kënaqur se këto dokumente me të vërtetë përbëjnë dëshmi të pronësisë. Të gjitha këto dokumente janë verifikuar nga Sekretaria Ekzekutive si vlefshme dhe konsiderohen si relevante. Shumë paraqitës të kërkesave gjithashtu kanë paraqitur dokumente mbështetëse shtesë, përfshirë vendimet mbi tatimin, deklaratat e dëshmitarëve, kopjet e planeve dhe vendimeve kadastrale.

11. Në 105 kërkesat e përmendura në pjesën A të Listës së bashkëngjitur, paraqitësi i kërkesës ka paraqitur kërkesën në cilësinë e bartësit të së drejtës pronësore. Në bazë të konstatimeve të Komisionit në paragrafin 10 më sipër, të gjitha këto kërkesa qëndrojnë të aprovohen.

12. Në 199 kërkesat e përmendura në pjesën B të Listës së bashkëngjitur, paraqitësit e kërkesave kanë paraqitur kërkesën në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të bartësit të së drejtës pronësore në bazë të nenit 1.2 të Aneksit II të UNMIK/ADM/DIR/2007/5 miratuar me Ligjin Nr. 03/L-079. Neni 1 i Urdhëresës Administrative i miratuar me Ligjin Nr. 03/L-079 përcakton që si “Anëtar i Bashkësisë Familjare” përfshihen “bashkëshorti/ja, fëmijët (të lindur brenda dhe jashtë martesës ose të adoptuar) dhe personat tjerë të cilët bartësi i së drejtës pronësore është i obliguar t’i mbështesë në pajtim me ligjin e aplikueshëm apo personat që janë të obliguar ta mbështesin bartësin e së drejtës pronësore në pajtim me ligjin e aplikueshëm pavarësisht nëse ata persona kanë banuar apo jo në pronë së bashku me bartësin e së drejtës pronësore.” Komisioni ka përcaktuar se, sipas ligjit të aplikueshëm, ky përkufizim përfshin përveç bashkëshortëve dhe fëmijëve gjithashtu edhe prindërit, vëllezërit, motrat, gjyshërit dhe nipat/mbesat e bartësit të së drejtës pronësore. Të gjithë paraqitësit e kërkesave në kërkesat e regjistruara në pjesën B të listës së bashkëngjitur përfshihen në përkufizimin e anëtarit të bashkësisë familjare. Rrjedhimisht, vendimi i cili konfirmon të drejtën pronësore në favor të bartësit të së drejtës pronësore qëndron të aprovohet në secilën kërkesë të regjistruar në pjesën B të listës së bashkëngjitur, siç është dhënë më sipër. Në kërkesat e regjistruara në kolonën përkatëse të pjesës B të listës së bashkëngjitur, paraqitësi i kërkesës pohon që bartësi i së drejtës pronësore ka vdekur por nuk ka paraqitur asnjë dëshmi të dokumentuar e cila do të dëshmonte vdekjen, dhe as Sekretaria Ekzekutive nuk ka mundur të gjejë ndonjë dokument të tillë. Rrjedhimisht, vendimi i cili konfirmon të drejtën pronësore në favor të bartësit të së drejtës pronësore gjithashtu qëndron të aprovohet në secilën nga këto kërkesa, siç është dhënë më sipër.

13. Në 174 kërkesat e përmendura në pjesën C të Listës së bashkëngjitur, paraqitësi i kërkesës apo bartësi aktual i së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, nuk ishte bartës i së drejtës pronësore në datën e humbjes së posedimit të pronës së kërkuar, por ka ofruar dëshmi që më vonë e ka trashëguar të drejtën përkatëse të pronësisë përmes trashëgimisë, kontratës mbi dhurimin apo kontratës mbi shitblerjen, siç mund të jetë rasti. Paraqitësi i kërkesës apo bartësi aktual i së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, duhet të konsiderohet si person i cili ka trashëguar të gjitha të drejtat të cilat i takojnë një pronari, përfshirë të drejtën për të kërkuar konfirmimin e pronësisë dhe riposedimin në procedurat aktuale. Prandaj këto kërkesa qëndrojnë të aprovohen, siç është dhënë më sipër. Në kërkesat e përmendura në kolonën përkatëse të kësaj pjese D të listës së bashkëngjitur, kërkesat janë paraqitur ose nga anëtari i bashkësisë familjare ose nga përfaqësuesi i autorizuar që vepron në emër të bartësit të së drejtës pronësore. Komisioni përcakton se paraqitësit e kërkesave në këto raste janë ose anëtarë të bashkësisë familjare të bartësit aktual të së drejtës pronësore në kuptim të nenit 1 të Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2007/5, miratuar me Ligjin Nr. 03/L-079 ose janë bartës aktualë të së drejtës pronësore që kanë përfaqësues të autorizuar të cilët posedojnë autorizim të vlefshëm dhe të zbatueshëm sipas nenit 5.2 të Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 miratuar me Ligjin Nr. 03/L-079, për të paraqitur kërkesë në emër të tyre. Komisioni vëren gjithashtu se ndërkohë që bartësi i së drejtës pronësore në kërkesën nr. 47015 ka siguruar autorizimin duke e autorizuar bartësin e autorizimit që të kërkojë kompensim për dëmin e shkaktuar nga KFOR-i në lidhje me pronën, ai ka konfirmuar po ashtu autorizimin për bartësin e autorizimit që të bëjë kërkesë për konfirmimin e pronësisë. (Kërkesa për kompensimin trajtohet në paragrafin 20 më poshtë).

14. Në 389 kërkesat e përmendura në pjesën D të listës së bashkëngjitur, paraqitësi i kërkesës nuk ishte bartës i së drejtës pronësore në datën e humbjes së posedimit të pronës së kërkuar, por pohon të ketë trashëguar pronën. Në secilën nga këto kërkesa paraqitësi i kërkesës ka dëshmuar se ai apo ajo është anëtar i bashkësisë familjare të bartësit të ndjerë të së drejtës pronësore. Megjithatë, nuk është paraqitur vendim i vlefshëm për trashëgiminë apo ndonjë dëshmi tjetër e dokumentuar nga paraqitësit e kërkesave që do të vërtetonte se ndonjëri nga paraqitësit e kërkesave të jetë trashëgimtar i pronës së kërkuar, dhe as Sekretaria Ekzekutive nuk ka mundur të gjejë ndonjë dokument të tillë. Disa paraqitës të kërkesave kanë paraqitur gjoja “vendime të trashëgimisë” të lëshuara nga gjykatat paralele në Serbi. Komisioni nuk konsideron që dokumentet e tilla mund të vërtetojnë të drejtën e trashëgimisë. Komisioni nuk ka juridiksion të zgjidhë çështjet që kanë të bëjnë me trashëgiminë. Rrjedhimisht, vendimi i cili konfirmon të drejtën pronësore në favor të bartësit të ndjerë të së drejtës pronësore qëndron të aprovohet në secilën nga këto kërkesa, siç është dhënë më sipër. Vendimi i Komisionit sa i përket të gjitha kërkesave të përmendura në këtë pjesë D të listës së bashkëngjitur, nuk cenon përcaktimin nga gjykata kompetente se si trashëgimtarët do të trashëgojnë të drejtën pronësore nga i ndjeri. Në kërkesat e regjistruara në kolonën përkatëse të kësaj pjese D të listës së bashkëngjitur, anëtari i bashkësisë familjare i bartësit të ndjerë të së drejtës pronësore është përfaqësuar nga personi fizik i autorizuar me autorizim. Komisioni ka përcaktuar që në secilën nga këto kërkesa personi fizik i autorizuar posedon autorizim të vlefshëm dhe të zbatueshëm të dhënë nga anëtari i bashkësisë familjare i bartësit të ndjerë të së drejtës pronësore sipas nenit 5.2 të Urdhresës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 miratuar me Ligjin Nr. 03/L-079. Rrjedhimisht, kërkesa qëndron të aprovohet në emër të bartësit aktual të ndjerë të së drejtës pronësore në secilën nga këto kërkesa. Në kërkesën Nr. 24183 bartësi i së drejtës pronësore në datën e humbjes dhe bartësi aktual i së drejtës pronësore kanë vdekur. Kërkesa është paraqitur nga motra e bartësit të ndjerë të së drejtës pronësore e cila pohon të ketë trashëguar pronën, megjithatë nuk ka paraqitur vendim të vlefshëm të trashëgimisë në lidhje me bartësin aktual të së drejtës pronësore. Prandaj kërkesa qëndron të aprovohet në emër të bartësit aktual të ndjerë të së drejtës pronësore.

15. Llojet e ndryshme të dokumenteve në të cilat janë mbështetur paraqitësit e kërkesave në përkrahje të kërkesave të cekura në paragrafët 10, 11, 12, 13 dhe 14 të mësipërm janë të regjistruara në kolonat përkatëse të pjesëve A, B, C dhe D të listës së bashkëngjitur.

16. Në një numër kërkesash, paraqitësit e kërkesave apo bartësit e së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, janë larguar nga prona jashtë periudhës prej 27 shkurtit 1998 deri më 20 qershor 1999, e cila parashihet në nenin 3 të Rregullores së 2006/50 miratuar me Ligjin nr. 03/L-079. Komisioni ka përcaktuar që, ndonëse data e largimit në këto kërkesa është jashtë periudhës së mësipërme, humbja e së drejtës pronësore në secilin rast është rezultat i rrethanave që ndërlidhen drejtpërsëdrejti me, apo që janë pasojë e konfliktit të armatosur që ka ndodhur në Kosovë mes 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999, siç kërkohet me nenin 3 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 miratuar me Ligjin nr. 03/L-079.

17. Në kërkesat nr 37857, 37834, 43146, 47121, 47122 dhe 47124 (të regjistruara në kolonën përkatëse të listës së bashkëngjitur) paraqitësit e kërkesave kërkojnë

konfirmimin e të drejtës së pronësisë mbi për pronat e kërkuara pa urdhër dëbimi pasi leja i është miratuar një personi të caktuar për të shfrytëzuar pronën e kërkuar. Në këto rrethana, urdhri i cili konfirmon të drejtën pronësore në favor të paraqitësit të kërkesës ose bartësit të së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, qëndron të aprovohet, pa ndonjë formë tjetër të ndihmës ligjore, ashtu si është përcaktuar më sipër.

18. Në kërkesën Nr. 13190, paraqitësi i kërkesës ka vdekur pas paraqitjes së kërkesës. Komisioni konsideron që vdekja e paraqitësit të kërkesës gjatë procedurës nuk mund të ndikojë në vlefshmërinë e kërkesës. Rrjedhimisht, vendimi i cili konfirmon të drejtën pronësore në favor të bartësit të së drejtës pronësore qëndron të aprovohet, siç është dhënë më sipër. Ky vendim nuk cenon përcaktimin nga gjykata kompetente se si trashëgimtarët do të trashëgojnë të drejtën pronësore nga i ndjeri.

19. Nga sa u tha më sipër, Komisioni është i kënaqur, bazuar në dëshmitë që i posedon se:

- (a) paraqitësi i kërkesës apo bartësi i së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, ka të drejtën e pronësisë në lidhje me pronën e kërkuar, apo pjesën e tillë siç është specifikuar në vendimin përkatës individual;
- (b) secila kërkesë është jokontestuese në kuptimin se asnjë person nuk e ka kontestuar vlefshmërinë e kërkesës;
- (c) paraqitësi i kërkesës apo bartësi i së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, në secilin rast tani nuk mund të ushtrojë të drejtën e tij apo të saj të pronësisë; dhe
- (d) kërkesa në secilin rast përfshin rrethanat e ndërlidhura drejtpërsëdrejti apo që janë pasojë e konfliktit të armatosur që ka ndodhur mes 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999.

B. Kërkesat për kompensim

20. Në kërkesat e përmendura në kolonat përkatëse të pjesëve A, B, C, dhe D të listës së bashkëngjitur, paraqitësit e kërkesave gjithashtu kërkojnë, përveç pronësisë, kompensim për dëmin material apo humbje të shfrytëzimit, të pronës së kërkuar. Sipas Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 miratuar me Ligjin Nr. 03/L-079 Komisioni nuk ka juridiksion mbi kërkesat e tilla. Rrjedhimisht, këto kërkesa duhet të refuzohen.

C. Vërejtjet përmbledhëse.

21. Nga sa u tha më sipër, Komisioni konstaton se kërkesat e regjistruara në pjesët A, B, C dhe D të listës së bashkëngjitur janë të suksesshme dhe urdhri sa i përket secilës kërkesë, të jepet siç është dhënë më sipër.

22. Në një numër kërkesash, paraqitësi i kërkesës ka paraqitur kërkesë për riposëdim të pronës së njëjtë edhe në Drejtoratin për Çështje Pronësore dhe Banesore, e cila kërkesë më pastaj ishte aprovuar nga Komisioni për Kërkesa Pronësore dhe Banesore ("HPCC").

Komisioni konstaton se mjetet e veprimit në dispozicion të paraqitësve të kërkesave para Komisionit aktual dhe HPCC-së, respektivisht, dhe, rrjedhimisht edhe juridiksioni i dy Komisioneve, nuk janë të njëjta në kuptimin se, ndryshe nga HPCC-ja, Komisioni aktual ka juridiksion për të konfirmuar pronësinë. Rrjedhimisht, vendimet e HPCC-së nuk përbëjnë *res judicata* para Komisionit aktual. Për më tepër, në rastet kur HPCC-ja ka aprovuar urdhrin për dëbim në favor të Paraqitësit të kërkesës, Komisioni nuk konsideron se një urdhër i tillë paraqet pengesë për këtë Komision që të lëshojë urdhër të ri për dëbim në rastet kur prona është e uzurpuar në mënyrë të paligjshme.

23. Vendimet dhe urdhri i mësipërm i Komisionit gjithashtu aplikohen, ku është e përshtatshme, edhe për çdo pronë të bashkuar, d.m.th. për çdo ndërtesë apo objekt tjetër të zotëruar apo të shfrytëzuar nga paraqitësi i kërkesës ose bartësi i së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, të cilat formojnë një njësi me pronën e kërkuar.

24. Neni 8.8 i Aneksit III të Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut nr. 2007/5 i miratuar me Ligjin 03/L-079 lejon Kryetarin e Komisionit të nënshkruajë vendimin grupor duke aprovuar të gjitha kërkesat individuale të identifikuara në vendimin grupor, nëse numri i kërkesave të vendosura gjatë seancës është i lartë. Komisioni konsideron se kjo është e përshtatshme në rastin konkret.



Kryetari

ANKESAT

Rregullorja e UNMIK-ut 2006/50 dhe Ligji Nr. 03/L-079 parashohin që:

12.1 Brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga njoftimi i palëve nga Agjencia Kosovare e Pronës për vendimin e Komisionit mbi kërkesën, pala mund të paraqesë ankesë kundër vendimit të tillë në Gjykatën Supreme të Kosovës përmes Sekretarisë Ekzekutive të Agjencisë Kosovare të Pronës.

12.3 Ankesa mund të paraqitet duke u bazuar në atë se:

- (a) Vendimi përmban gabim thelbësor apo shkelje serioze të së drejtës materiale apo procedurale; apo
- (b) Vendimi mbështetet në vlerësim të gabuar apo të mangët të fakteve.

Informacione shtesë lidhur me procedurën e ankesave gjenden në Faqen e veçantë të Informacioneve për Ankesa e cila u ofrohet palëve së bashku me vendimin.

*** Versioni në gjuhën angleze është versioni zyrtar i të gjitha vendimeve të Komisionit për Kërkesa Pronësore. Në rast të mospërputhjes mes versionit në gjuhën angleze dhe versionit në gjuhën shqipe apo serbe, atëherë mbizotëron versioni në gjuhën angleze.**

Spreadsheet /Lista /Prilog
Part A/Pjesa A/Deo A

KPA44559	KPA00632	KPA00633	KPA00634	KPA06040	KPA06907	KPA06915
KPA08180	KPA08358	KPA08359	KPA20182	KPA23226	KPA31414	KPA36385
KPA44556	KPA45175	KPA50516	KPA52434	KPA52435	KPA53937	KPA90147
KPA06148	KPA06152	KPA28707	KPA28708	KPA28710	KPA28711	KPA29117
KPA37856	KPA37857	KPA41173	KPA41175	KPA41176	KPA44560	KPA48204
KPA48206	KPA48207	KPA48762	KPA48764	KPA56637	KPA56635	KPA06988
KPA07962	KPA10574	KPA10610	KPA11030	KPA18409	KPA23074	KPA26692
KPA31104	KPA34008	KPA44557	KPA47374	KPA47375	KPA48203	KPA48205
KPA48763	KPA53107	KPA56631	KPA56633	KPA56726	KPA06916	KPA08332
KPA15256	KPA17882	KPA17963	KPA22825	KPA22826	KPA25921	KPA26689
KPA33449	KPA36238	KPA38343	KPA44102	KPA45418	KPA45421	KPA46218
kPA47953	KPA49130	KPA56723	KPA01460	KPA08753	KPA10443	KPA10444
KPA13647	KPA16153	KPA17961	KPA18367	KPA19303	KPA21783	KPA22824
KPA25341	KPA26694	KPA29070	KPA33127	KPA41174	KPA50489	KPA50895
KPA51645	KPA52401	KPA53739	KPA53741	KPA53842	KPA40424	KPA53738

Spreadsheet /Lista /Prilog
Part B/Pjesa B/Deo B

KPA07521	KPA07531	KPA07536	KPA07541	KPA07550	KPA27287	KPA37565
KPA37566	KPA37567	KPA37568	KPA37569	KPA37571	KPA37572	KPA37573
KPA38918	KPA52421	KPA50530	KPA56543	KPA56544	KPA45130	KPA38594
KPA21707	KPA21708	KPA21709	KPA21710	KPA21711	KPA21712	KPA21713
KPA26136	KPA26138	KPA30862	KPA35916	KPA41577	KPA41582	KPA45125
KPA45126	KPA45127	KPA45128	KPA45129	KPA48938	KPA47121	KPA47124
KPA07551	KPA07553	KPA07555	KPA07556	KPA25174	KPA25178	KPA27286
KPA27290	KPA31051	KPA31054	KPA31055	KPA37165	KPA37168	KPA48082
KPA48226	KPA48538	KPA47122	KPA29156	KPA56542	KPA07549	KPA25175
KPA25177	KPA25179	KPA26248	KPA27294	KPA28502	KPA25916	KPA30020
KPA37157	KPA52296	KPA52409	KPA52411	KPA52413	KPA52416	KPA54420
KPA50366	KPA24299	KPA24300	KPA10400	KPA14448	KPA14453	KPA22458
KPA26135	KPA26137	KPA26428	KPA26429	KPA29596	KPA29598	KPA34773
KPA34774	KPA36695	KPA37750	KPA45124	KPA50365	KPA38592	KPA27972
KPA34766	KPA34767	KPA37137	KPA37138	KPA37139	KPA37140	KPA37141
KPA37142	KPA37148	KPA38581	KPA38583	KPA38584	KPA38585	KPA38586
KPA38587	KPA38588	KPA38589	KPA38590	KPA54195	KPA43146	KPA07543
KPA07544	KPA07552	KPA25742	KPA25747	KPA30926	KPA30927	KPA30928
KPA30929	KPA33723	KPA37108	KPA37499	KPA37748	KPA47001	KPA47009
KPA47013	KPA47016	KPA48731	KPA26139	KPA29592	KPA34768	KPA34769
KPA34770	KPA34771	KPA34772	KPA34776	KPA34779	KPA37143	KPA37144
KPA37145	KPA37146	KPA37147	KPA37149	KPA38582	KPA38591	KPA48656

KPA48730	KPA52429	KPA00769	KPA07547	KPA27444	KPA47003	KPA47014
KPA52418	KPA52422	KPA52428	KPA52420	KPA17780	KPA27288	KPA27298
KPA29040	KPA29041	KPA29042	KPA29044	KPA29045	KPA30925	KPA34471
KPA35695	KPA37111	KPA37500	KPA38214	KPA52412	KPA56570	KPA25593
KPA10396	KPA11642	KPA14171	KPA14173	KPA14175	KPA26430	KPA26431
KPA29602	KPA29603	KPA38207	KPA38685	KPA52194	KPA56498	KPA54370
KPA38049	KPA28585	KPA47452				

Spreadsheet /Lista /Prilog
Part C/Pjesa C/Deo C

KPA53851	KPA06439	KPA06444	KPA25804	KPA26714	KPA27236	KPA32061
KPA32062	KPA32067	KPA32072	KPA32073	KPA32075	KPA32077	KPA39994
KPA39998	KPA40007	KPA40010	KPA40012	KPA44545	KPA44555	KPA44542
KPA06438	KPA21758	KPA21759	KPA24371	KPA26707	KPA26709	KPA26710
KPA26712	KPA26713	KPA26715	KPA27232	KPA27234	KPA32063	KPA32068
KPA32069	KPA32071	KPA32078	KPA36418	KPA36419	KPA40025	KPA16388
KPA24475	KPA25797	KPA25801	KPA33252	KPA39984	KPA39985	KPA39986
KPA39993	KPA39995	KPA40000	KPA40001	KPA40003	KPA40006	KPA40009
KPA40015	KPA40017	KPA40023	KPA40024	KPA53089	KPA25800	KPA26747
KPA27934	KPA39989	KPA39991	KPA40002	KPA40004	KPA40005	KPA40016
KPA40020	KPA40021	KPA44551	KPA50910	KPA50952	KPA52018	KPA52019
KPA52190	KPA53086	KPA53088	KPA54004	KPA25802	KPA25805	KPA25806
KPA20133	KPA25813	KPA28593	KPA30539	KPA35265	KPA35268	KPA35269
KPA35272	KPA35317	KPA35319	KPA36391	KPA39988	KPA40022	KPA52440
KPA53092	KPA53093	KPA53782	KPA20132	KPA25803	KPA25808	KPA25809
KPA25811	KPA26745	KPA26746	KPA39992	KPA44532	KPA44541	KPA44544
KPA44546	KPA44547	KPA48943	KPA48944	KPA48987	KPA53079	KPA53087
KPA54050	KPA25810	KPA25812	KPA26705	KPA27533	KPA30538	KPA44530
KPA44539	KPA44550	KPA50484	KPA50486	KPA51630	KPA51632	KPA52023
KPA52130	KPA52131	KPA54044	KPA54046	KPA54047	KPA54049	KPA47015
KPA06553	KPA16330	KPA16331	KPA19019	KPA27269	KPA27806	KPA27807
KPA31148	KPA36398	KPA36406	KPA36409	KPA44552	KPA44648	KPA44945
KPA48945	KPA50487	KPA50802	KPA51633	KPA53838	KPA06334	KPA21760
KPA26066	KPA36366	KPA37271	KPA44100	KPA44647	KPA48946	KPA50220
KPA52125	KPA52127	KPA52128	KPA39400	KPA52126	KPA32423	

Spreadsheet /Lista /Prilog
Part D/Pjesa D/Deo D

KPA50934	KPA06071	KPA26166	KPA26167	KPA26168	KPA26173	KPA26176
KPA26177	KPA27216	KPA27217	KPA30944	KPA31988	KPA31993	KPA32007
KPA32011	KPA32013	KPA38186	KPA38187	KPA38195	KPA48971	KPA06948
KPA26449	KPA26450	KPA26454	KPA32003	KPA32014	KPA32088	KPA32091
KPA38188	KPA38191	KPA39951	KPA39953	KPA39956	KPA39957	KPA44117
KPA50115	KPA50116	KPA50117	KPA50119	KPA52454	KPA27330	KPA27331
KPA27337	KPA30564	KPA32010	KPA47838	KPA47839	KPA47840	KPA47841
KPA47842	KPA47844	KPA47845	KPA47846	KPA50127	KPA50128	KPA50131
KPA50924	KPA50925	KPA50937	KPA47843	KPA26219	KPA26451	KPA26674
KPA27326	KPA27329	KPA27335	KPA27336	KPA27338	KPA27339	KPA27340
KPA27341	KPA28441	KPA30561	KPA30565	KPA30566	KPA30567	KPA30808
KPA31865	KPA32012	KPA53693	KPA13910	KPA15008	KPA21680	KPA21681
KPA27215	KPA27327	KPA27343	KPA30961	KPA30962	KPA30562	KPA30563
KPA33989	KPA37629	KPA39783	KPA39950	KPA40125	KPA48979	KPA50121
KPA53247	KPA53694	KPA34715	KPA45134	KPA45137	KPA49697	KPA49698
KPA50023	KPA50025	KPA50026	KPA50033	KPA50047	KPA50054	KPA50961
KPA52056	KPA53231	KPA53232	KPA53233	KPA53241	KPA53248	KPA53243
KPA01261	KPA26172	KPA27880	KPA30953	KPA31368	KPA32090	KPA32110
KPA34264	KPA34707	KPA34709	KPA34711	KPA44116	KPA44881	KPA48042
KPA48974	KPA48975	KPA48977	KPA49238	KPA51569	KPA53230	KPA07093
KPA24315	KPA16355	KPA26171	KPA30952	KPA30954	KPA30955	KPA30956
KPA30957	KPA32083	KPA32086	KPA32093	KPA32096	KPA32102	KPA32111
KPA47703	KPA48903	KPA48904	KPA48905	KPA53236	KPA14027	KPA16352
KPA30951	KPA32087	KPA32089	KPA32098	KPA32109	KPA34712	KPA34714
KPA35517	KPA37315	KPA37624	KPA38897	KPA38898	KPA38900	KPA44885
KPA47704	KPA47783	KPA51565	KPA53692	KPA06175	KPA25696	KPA32092
KPA32106	KPA34024	KPA37316	KPA37319	KPA38190	KPA48978	KPA49236
KPA49240	KPA50028	KPA50030	KPA50041	KPA50048	KPA50106	KPA53696
KPA26145	KPA30947	KPA32104	KPA37639	KPA38891	KPA38892	KPA44107
KPA44109	KPA44886	KPA48973	KPA48980	KPA49239	KPA50031	KPA50035
KPA50036	KPA50038	KPA50108	KPA53239	KPA52608	KPA17074	KPA25918
KPA30945	KPA30948	KPA30949	KPA31229	KPA32084	KPA32094	KPA32099
KPA32100	KPA32101	KPA32105	KPA32107	KPA38903	KPA38905	KPA50032
KPA50841	KPA50045	KPA01290	KPA21717	KPA30942	KPA30943	KPA30950
KPA30958	KPA30959	KPA30960	KPA34034	KPA36490	KPA36960	KPA38277
KPA38895	KPA38896	KPA38910	KPA38967	KPA39218	KPA47835	KPA48972
KPA56546	KPA14401	KPA14410	KPA16167	KPA16347	KPA16367	KPA25374
KPA37313	KPA37314	KPA38893	KPA38904	KPA44882	KPA50040	KPA50056
KPA50058	KPA50114	KPA50122	KPA50123	KPA50124	KPA56539	KPA50055
KPA07094	KPA15272	KPA15278	KPA15279	KPA19133	KPA24318	KPA27688

KPA27693	KPA30946	KPA32117	KPA38890	KPA38899	KPA38909	KPA50044
KPA50046	KPA50049	KPA50050	KPA50051	KPA50053	KPA56777	KPA07123
KPA11471	KPA11472	KPA15280	KPA24336	KPA26452	KPA40365	KPA40369
KPA40374	KPA40375	KPA40377	KPA44883	KPA50110	KPA50503	KPA52306
KPA55146	KPA56773	KPA56774	KPA56776	KPA56772	KPA37834	KPA06130
KPA07111	KPA24353	KPA11258	KPA24471	KPA37311	KPA40288	KPA40366
KPA40367	KPA40368	KPA40370	KPA40371	KPA40372	KPA40373	KPA41590
KPA45142	KPA51864	KPA52495	KPA53242	KPA15284	KPA07103	KPA07104
KPA11259	KPA13681	KPA24327	KPA24337	KPA31440	KPA33415	KPA36181
KPA36191	KPA37312	KPA38663	KPA38907	KPA38908	KPA47941	KPA51859
KPA51860	KPA52305	KPA52603	KPA06234	KPA06238	KPA06244	KPA10427
KPA16353	KPA37820	KPA39562	KPA39773	KPA41105	KPA42273	KPA46219
KPA47702	KPA47706	KPA47707	KPA49675	KPA50043	KPA50111	KPA50133
KPA52067	KPA48902	KPA24183	KPA27094	KPA01008	KPA01009	KPA01010
KPA06949	KPA25776	KPA34716	KPA47781	KPA38811	KPA29094	KPA29130
KPA46145	KPA49232	KPA54235	KPA47622			